REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 81/17, 86/17, 91/17
Datë/Datum. 13.04.2017
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës

Republika Kosova –Republic of Kosovo

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEË BODY

AKT PËRCJELLËS

REFERENCË:	**81/17, 86/17/91/17**
PËR:	- Zyrtarin e prokurimit të AK-së: **Komuna e Gjakovës** - Parashtruesit të ankesës: , OE **"Euroasphalt" sh.p.k .- Gjakovë** dhe **N.N.T.SH. "Drini Company"shpk Prizren**
CC:	- Panelit Shqyrtues në OSHP, - Arkivës në OSHP
NGA:	Sabrije Bullatovci, Eksperte shqyrtues e prokurimit: Bullatovci
TEMA:	Raporti i vlerësimit të ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar: **"Lika Trade" sh.p.k. – Deçan,** me nr. protokollit 81/17, ankesën e OE **"Euroasphalt" sh.p.k .- Gjakovë**, me numër protokollit 86/17 dhe ankesën e OE **N.N.T.SH. "Drini Company"shpk Prizren**, me numër protokollit 91/17, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Ndërtimi i rrugës Bujar Roka – pjesa jugore e qytetit në Gjakovë"**, me nr. të prokurimit: **632/16/081/511**, kundër vendimit të Autoriteti Kontraktues (AK): **Komuna e Gjakovës.**

Lokacioni:	Prishtinë	Data:	13.04.2017
PËR AKTIVITET			X
SIÇ ËSHTË KËRKUAR			X
PËR KOMENTE			X
PËR INFORMIMIN TUAJ			X

Bazuar në nenin 113 dhe 114 të LPP të Kosovës, ju njoftojmë me raportin e ekspertizën lidhur me aktivitetin e prokurimit: **"Ndërtimi i rrugës Bujar Roka – pjesa jugore e qytetit në Gjakovë"**, me nr. të prokurimit: **632/16/081/511**, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – **Komuna e Gjakovës**, si dhe me përgjigjen ndaj pretendimeve ankimore të OE ankues: **"Lika Trade" sh.p.k. – Deçan,** OE **"Euroasphalt" sh.p.k .- Gjakovë** dhe **OE "Drini Company"shpk Prizren**, me numër protokollit: 81/17, 86/17, 91/17.

Konform nenit *113 dhe 114*, Pjesa IX e LPP-së, eksperti shqyrtues i pavarur , ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë si dhe kërkesën e AK-së, dhe ka konstatuar si më poshtë:

AK është i thirrur që pas marrjes së raportit të ekspertit shqyrtues lidhur më këtë procedurë të prokurimit përkatësisht pretendimeve të bëra në ankesë,të veprojnë sipas kërkesave të nenit 115 të LPP-së.
Të bashkangjitur gjeni raportin e ekspertit shqyrtues dhe ekspertit teknik.

RAPORTI I EKSPERTIT SHQYRTUES

Bullajoni		03.04.2017		04.04.2017		13.04.2017
Nënshkrimi i ekspertit		*data e autorizimit të eksp.*		*data e fillimit të ekspertizës*		*data e dorëzimit të raportit*

N. 99, LPP - Baza ligjore e shqyrtimit-

Me datë: 21.03. 2017, Organi Shqyrtues i Prokurimit, ka pranuar ankesën e parashtruar nga OE: **"Lika Trade" sh.p.k. – Deçan,** dhe OE **"Euroasphalt" sh.p.k .- Gjakovë**, si dhe me dt. 30.03.2017, ankesën e parashtruar nga OE **"Drini Company"shpk Prizren,** lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **"Ndërtimi i rrugës Bujar Roka–pjesa jugore e qytetit në Gjakovë",** me nr. të prokurimit: **632/16/081/511**, iniciuar nga autoriteti kontraktues (AK) – **Komuna e Gjakovës.**
Konform nenit 113 dhe 114, Pjesa VIII e LPP-së, Eksperti Shqyrtues i OSHP-së e ka shqyrtuar dhe analizuar procesin e prokurimit në fjalë, dhe ka konstatuar si më poshtë:

N. 109,-Operatoret Ekonomik Ankues: "Lika Trade" sh.p.k. – Deçan

Pikat e Ankesës:

Nuk është zbatuar

LIGJI Nr.04/L-042 PER PROKURIMIN PUBLIK NE REPUBLIKEN E KOSOVES.

Neni 1.36. Tenderet e pa pergjegjshem - Tenderet te cilet nuk jane ne perputhje me:

a) Dosjen e tenderit, duke perfshire kerkesat teknike dhe kontraktuale

b) Kerkesat e legjislacionit perkates

c) Nuk permbushin kerkesat e autoritetit kontraktues siq jane specifikuar ne dosjen e tenderit.

Duke marrë në konsideratë se ligji e përkufizoon tenderin e papërgjegjshëm, kompania jonë ka ofruar një tender të përgjegjshëm në përputhie të plotë me dosjen e tenderit, me çka LPP çdo here i referohet dosjes së tenderit si kusht themelor që duhet te plotësohet nga kompanitë. Ne kemi ofruar një tender te pergjegjshem dhe Autoriteti Kontraktues nuk e ka respektuar Ligjin për t'na shpallur neve si fitues i ketij projekti, por shpallë një kompani te papergjeshme si fituese te projektit ne fjale.

Janë cenuar dispozitat e Nenit 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i tendëreve.

Janë shkelur dispozitat e Nenit 60 Kriterët për Dheniën e Kontratës, ku theksohet:

Autoriteti kontaktues duhet t'ja jap kontraten publike operatorit ekonomik qe ka dorezuar ***Tenderin e përgjegjshem me cmimin me te ultë.***

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

Letrën standarde për eliminim e kemi pranuar në email-in zyrtarë me datën 07.03.2017 në të është përcaktuar se ne jemi Eliminuar nga ky Aktivitet i prokurimit, por ky vendimi që është marrë parasheh shkelje të nenit 59 pika 1 të LPP-së.

Komisioni vlerësues, ashtu siç ka detyrë dhe përgjegjësi, nuk ka shqyrtuar dhe verifikuar saktë dhe drejtë dokumentacionin e paraqitur nga Kompania "LIKA TRADE" sh.p.k. Mes shkeljeve të tjera të cilat do ti theksojmë, konsiderojmë se Komisioni vlerësues ka shkelur edhe parimet themelore të përcaktuara në nenin 104 të LPP-së si dhe parimin bazë të prokurimit publik - parimi i barazisë në trajtim / Jo-diskriminimi.

Arsyeja e cekur e eliminimit nuk qëndron për vet faktin se nuk ka qenë e kërkuar as në Njoftimin për Kontratë e as në Dosjen e tenderit dhe nuk merret për bazë diçka që nuk kërkohet, e aq me tepër për eliminim nga një aktivitet i prokurimit.

Eliminimi i tille nga Autoriteti Kontraktues është tendencioz, dhe na shtynë që të besojmë që është bërë për favorizim dhe për interesa të ngushta të ndonjë subjekti, ku shpallet fituese e këtij Aktiviteti te prokurimit OE "PE-VLA-KU" sh.p.k ***me çmim shumë më të lartë, mbi 61 mij euro.***

Ne jemi "Eliminuar" nga AK përpikat e poshtëshënuara:

Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:

- Plani dinamik për kryerjen e punimeve nuk është ofruar, ashtu siq është kërkuar në dosje të

tenderit, ne piken 9.2. te FTD-se. Ne dosje është kërkuar 100 kalendarike. Ju keni parapare planin dinamik i cili fillon me date 05.02.2017 deri me date 25.06.2017 qe ne total janë 140 dite kalendarike, d.m.th. është ne kundërshtim kërkesën e AK.

- Ne piken 9.2. te dosjes se tenderit - përshtatshmëria profesionale jane kërkuar dëshmi te cilat do te dorëzohen me rastin e ofertimit. Ju keni dështuar qe te ofroni dëshmi te përshtatshmërisë profesionale dhe teknike sipas kërkesave te dosjes se tenderit. Pasi qe nuk keni prezantuar autorizimet nga prodhuesit apo dileri i autorizuar për pajisje elektrike, trupa ndriçues, sinjalizim horizontal dhe vertikal.

Ne si Operator Ekonomik aplikojmë në të gjitha Autoritetet Kontraktues si ne nivelin Qendror ashtu edhe në Nivelin Lokal, por pothuajse asnjëherë nuk jemi shpallur të pa përgjegjshëm. E sidomos në këtë Aktivitet të prokurimit i kemi plotësuar në përpikmëri të gjitha pikat e kërkuara nga Autoriteti kontraktues në Dosjen e Tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.

Sqarim:

Plani dinamik për kryerjen e punimeve është ofruar konform kërkesë së AK-se prej 100 ditëve kalendarike. Mund të shihet qartë se shkruan me ngjyrë te theksuar numri i ditëve (100days) qe kemi ofruar për kryerjen e punëve. Ndërsa llogaritja e AK-se në bazë të pozicioneve (aktiviteteve) është komplet e gabuar dhe jo profesionale pasi që ne realizimin e një projekti, përkatësisht një rruge bëhen disa pozicione (aktivitete) të ndryshme brenda ditës dhe që në total rezulton me numrin e ofruar prej

100 ditëve për të cilin prapë zotohemi se do ta realizojmë projektin.

Ne piken 9.2. te dosjes se tenderit - përshtatshmëria profesionale nuk është e vërtete qe janë kërkuar nga AK dëshmi të cilat do te dorëzohen me rastin e ofertimit. Janë kërkuar për fituesin dhe është cekur (vlenë për OE fitues). Gjithashtu janë RI-SQARUAR se VLENË PER OE FITUES, ne letrën për sqarime te dërguar nga Autoriteti kontraktues (Komuna e Gjakoves) me datën 23.01.2017. Ne, kemi jep Deklaratë me shkrim në ofertën tonë (për dokumentet që do të dorëzohen në rast se shpallemi fitues) sipas kërkesës se AK, siç janë:

Dokumentet:

Autorizimin e prodhuesit ose dilerit për sinjalizim horizontal dhe vertikal.

Do ti prezantoj të gjitha produktet sipas standarde Evropiane (të specifikuara në annex 1 - specifikimet teknike të detyrueshme), - do të ofrohen certifikata për origjinën e produkteve të ofruara. Garancionin nga prodhuesi dhe ofertuesi veq e veq, - Për produktet e specifikuara në annex 1 - specifikimet teknike të detyrueshme. Për të gjitha prodhimet (prodhuesi) do të jenë të certifikuara me EN ISO 9001. Certifikata EN dhe protokolle të testimit për produktet e ofruara - sipas annex 1 - specifikimet teknike të detyrueshme.

Gjeni te bashkangjitur më poshtë kërkesën përpiken 9.2 nga AK nga Dosja e tenderit:

- Operatori Ekonomik duhet të dorëzoj garancionin nga prodhuesi dhe ofertuesi veq e veq. Për produktet e specifikuara me annex 1 - specifikimet teknike te detyrueshme (vlen për OE fitues).
- Operatori Ekonomik për të gjitha prodhimet (prodhuesi) duhet të jenë të certifikuara me EN ISO 9001 (vlen për OE fitues).
- Operatori Ekonomik duhet të ketë certifikatën ISO 9001
- Operatori Ekonomik duhet te ketë certifikatën ISO 39001:2012 (Road traffic safety management system (vien për OE fitues).
- Operatori Ekonomik duhet të prezantoj certifikata EN dhe protokolle të testimit për produktet e ofruara - sipas annex 1 . specifikimet teknike të detyrueshme (vlen për OE fitues).
- Plani dinamik i nënshkruar dhe i vulosur jo më shumë se 100 dite kalendarike.

Andaj kërkojmë nga Ju si që lëndën ta ktheni në Ri-Vlersim duke respektuar Kriteret për dhënie te kontraktues siç i ka përcaktuar Autoriteti Kontraktues ne Dosjen e tenderit dhe në Njoftimin për Kontratë.

Duke ju referuar kritereve te kërkuara ne Njoftimin për Kontrate dhe ne Dosjen e tenderit ne i kemi përmbushur te gjitha kriteret. Kërkojmë fuqishëm nga ju qe lënden ta ktheni ne Ri-Vleresim dhe te na shpallni fitues konform kritereve te kërkuara në Njoftimin për Kontrate dhe ne Dosjen e tenderit duke respektuar LPP-në

Gjithashtu ju përkujtojmë se ne si Operator Ekonomik i kemi përmbushur te gjitha kriteret e kërkuar ne Njoftimin për Kontrate dhe Dosjen e Tenderit.

Veçanërisht të respektoj Ligjin e Prokurimit Publik te Republikës së Kosovës

Propozim:

Kompania jonë shfaqë besimin e plotë ne ndarjen e drejtesise nga Organi Shqyrtues i Prokurimit dhe nga i njejti kërkon qe t'i ftoj te gjitha palet ne nje ballafaqim ne panel, e pasi ti degjojë ato te nxjerrë vendim me te cilin detyron AK-Komuna e Gjakovës qe ta respektoj Ligjin e Prokurimit Publik, nderkaq Lenden ta kthej ne Ri-Vlerësim dhe ne te shpallemi Fitues nga nje komision vleresues Profesional si Operator Ekonomik i përgjegjëm me çmimin më të Ultë në shumë prej 61,358,64 e. Me çrast kërkojmë nga OSHP që mos t'lejoi demtimin e Buxhetit të Republikës së Kosovës.

N. 109,-Operatoret Ekonomik Ankues: "Euroasphalt" sh.p.k .- Gjakovë

Pikat e Ankesës:

Supozojmë se janë shkelur këto dispozita ligjore të Ligjit Nr.04/L-042 për Prokurimin Publik:

Neni 7 - Barazia në Trajtim / Jo Diskriminimi (LPP)

Neni 20 - Specifikimet Teknike (UOPP)

Neni 27 - Dosja e Tenderit (LPP)

Neni 28 - Specifikimet Teknike (LPP)

Neni 59 - Ekzaminimi, Vlerësimi dhe Krahasimi i Tenderëve (LPP)

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

1. Pretendimi i parë i yni ankimor është se Autoriteti Kontraktues ka rekomanduar për dhënie të kontratës OE "PE-VLA-KU" SH.P.K - Dega në Kosovë i cili sipas dokumentacionit të ofruar në ofertën e tij rezulton si i papërgjegjshëm pasi që:

- Autoriteti Kontraktues ka kërkuar tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale pozicioni 9.1 i FDT-së "**AUTORIZIMIN e prodhuesit ose dilerit** për Sinjalizim Horizontal dhe Vertikal" ku si dëshmi pra është kërkuar në pozicionin 9.2 të FDT-së "Operatori Ekonomik duhet të dorëzoj autorizimin e prodhuesit apo dilerit për sinjalizim horizontal dhe vertikal", me çrast Operatori Ekonomik "PE-VLA-KU" SH.P.K - Dega në Kosovë ka dorëzuar dy dokumente nga kompanitë prodhuese. **VERNISOL** për sinjalistikë horizontale dhe nga kompania prodhuese **TAMBURRINI ALESSANDRO** për sinjalistikë vertikale, që të dya kompani ITALIANE ku që të dya dokumente i janë lëshuar kompanisë **IDK-KONSTRUKTION** me seli në Shqipëri të cilat dokumente nuk janë **AUTORIZIM** dhe nuk kanë përmbajtjen e as titullin si **AUTORIZIMI**, ku dokumentet janë të ndarë në dy tabela, ku në anën e majtë prezantohet dokumenti si **DICHTARAZIONE** në gjuhën italiane dhe përmbajtja është në gjuhën italiane dhe në anën e djathtë të dokumentit prezantohet përkthimi në gjuhën shqipe si **DEKLARATË**, pra që të dya dokumente dmth thjeshtë janë deklarata dhe nuk mund të konsiderohen si AUTORIZIME, andaj ne shohim se kjo kompani / operator ekonomik nuk ka arritur të dëshmoj me AUTORIZIM -et se kompania e lartëcekur autorizohet nga prodhuesit.

Autoriteti Kontraktues ka kërkuar të dëshmohen duke prezantuar Operatorët Ekonomik autorizime dhe jo deklarata nga prodhuesit, andaj ky operator rezulton të jetë i papërgjegjshëm pasi që nuk plotëson këtë kërkesë.

Sipas pikës 41.5 të Nenit 41 të UOPP-së, Tenderi konsiderohet të jetë i përgjegjshëm kur:

a. është në pajtueshmëri nga aspekti administrativ me kërkesat formale të dosjes së tenderit, b. është në pajtueshmëri në termet teknike me përshkrimin, kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në dosje të tenderit; c. është dorëzuar nga operatori ekonomik që përmbush kriteret e përzgjedhjes të përcaktuara në dosje të tenderit.

Pra sipas këtij paragrafi dhe sipas Nenit 59 të LPP-së, operatori i rekomanduar për dhënie të kontratës është i papërgjegjshëm në aspektin teknik dhe profesional.

2. Pretendimi ynë i dytë ankimor është se Operatori Ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk ka arritur që të dëshmoj pas shpalljes fitues për disa produktet e cekura në Specifikacionin Teknik të Detyrueshëm që janë të certifikuara sipas EN certifikatave dhe nuk ka prezantuar protokoll-raporte të testimit (analiza).

OE i rekomanduar pas shpalljes fitues si kërkesë të Autoritetit Kontraktues është dashur që të plotësoj kërkesën e mëposhtëm mirëpo gjatë analizimit të dokumentacionit të OE "PE-VLA-KU" SH. P.K. shihet kjartazi që për disa produkte të specifikuara mungojnë këto dëshmi.

- Operator Ekonomik duhet të prezantoi certifikata EN dhe protokolle të testimit për produktet e ofruar –sipas anexit 1- specifikimet teknike te deturushme vlene per OE fitues).

a) OE "PE-VLA-KU" SH. P.K ka vendosur certifikata të saja për ISO standarde, dhe ka vendosur certifikata të ISO standardeve për **IDK KONSTRUKSION** me seli në Shqipëri, për produktet e sinjalistikës horizontale dhe vertikale **ekzistojnë** certifikatat e EN të kompanive italiane VERNISOL dhe TAMBURRINI ALESSANDRO, si dhe i ka bashkangjitur raportet e testimit (analizave), mirëpo siç e kemi cekur më lartë IDK KONSTRUKSTION nuk ka prezantuar AUTORIZIM se është i autorizuar nga këto dy kompani mirëpo ka ofruar vetëm DEKLARATA dhe jo AUTORIZIME.

b) OE "PE-VLA-KU" SH. P.K ka vendosur certifikata të saja për ISO standarde, dhe ka vendosur certifikata të ISO standardeve për **ITE GRUP** me seli në Shqipëri, për produktet elektrike, ndriqimit dhe kabllove elektrike nuk egzistojnë certifikatat e EN dhe as protokoll-raporte të testimit (analizave) për këto produkte nga prodhuesi GE HUNGARY, ky prodhues nuk ka EN certifikata e as raporte; por ka prezantuar vetëm certifikata të ISO standardeve. Gjithashtu OE i rekomanduar për kontratë ka prezantuar një dokument të një kompanie **PRYSMIAN GROUP** me seli në Amerikë, e cila poashtu ka vetëm certifikatë të ISO standardeve dhe jo EN certifikata dhe nuk ka asnjë dëshmi për protokoll-raporte të testimit (analizave) pos një katalogu, por që nuk figuron as prodhuesi GE HUNGARYas dileri ITE GRUP e as OE i rekomanduar për kontratë "PE-VLA-KU" që janë të AUTORIZUAR për shitjen e produkteve të saja (kabllot) nga ana e PRYSMIAN GROUP.

c) OE "PE-VLA-KU" SH.P.K ka vendosur certifikata të saja për ISO standarde, dhe ka vendosur certifikata të ISO standardeve për **GERMAN PLAST** me seli në Junik, për produktet e gypave për ujësjellës nuk egzistojnë certifikatat e EN dhe as protokoll raporte të testimit (analizave) për këto produkte, prodhuesi vendor ka prezantuar vetëm certifikatat e ISO standardeve.

d) OE "PE-VLA-KU" SH. P.K ka vendosur certifikata të saja për ISO standarde, dhe ka vendosur certifikata të ISO standardeve për **FERPLAST** ne seli në Ferizaj, për produktet e gypave për kanalizim egzistojnë certifikatat e EN dhe protokoll-raporte të testimit (analizave) për këto produkte, prodhuesi vendor i ka prezantuar dokumentet e nevojshme për këto produkte.

Prodhues janë:

- GE HUNGARY (për produkte elektrike) (a)
- VERNISOL (për produktet e sinjalistikës horizontale) (b)
- TAMBURRINI ALESSANDRO (për produktet e sinjalistikës vertikale) {c)
- PRYSMIAN GROUP (për kabllo elektrike) (d)
- GERMAN PLAST (për gypa të ujësjellësit) (e) –

FER PLAST (për gypa të kanalizimit) (f)

Diler/Distributor janë:

- ITE GRUP i autorizuar nga GE HUNGARY (Lighting) (a)
- IDK KONSTRUKSION për VERNISOL dhe TAMBURRINI ALESSANDRO (mungon autorizimi) (b) (c)
- Nuk ka distributor, sepse shtrihet pothuaj në gjithë Europën dhe ka seli të veta (d)
- PE-VLA-KU i autorizuar nga GERMAN PLAST (e)
- PE-VLA-KU i autorizuar nga FER PLAST (f)

Pra certifikatat EN dhe certifikatat e ISO standardeve dallojnë sepse kuptimi i EN është (European Standard) dhe kuptimi i ISO është (international Organization for Standardization).

Burimi. (https://ËëË. Ëuerthindustrie.com/iveb/en/Ëuerth industrie/technikportal/dineniscuinterschiede/unterscheidu ng_diniSo.php)

3. Pretendimi ynë i tretë ankimor është se Autoriteti Kontraktues nuk ka përpiluar dosjen e tenderit në rregull ashtu siç obligohet, më poshtë kemi cekur se:

Autoriteti Kontraktues Komuna Gjakovë përkatësisht zyra e prokurimit nuk e ka rrespektuar vendimin e KRPP-së lidhur me zbatimin e platformës së e-prokurimit nr.112/2016 të datës 31.08.2016, duke mos e cekur / plotësuar - sqaruar tek pozicioni 19.1 (h) e FDT-së (dosjes së tenderit) që tenderi duhet të dorëzohet në njërën nga format "në mënyrë elektronike ose fizike" (në asnjë mënyrë në të dy versionet), me çrast neve si operator ekonomik na ka shkaktuar probleme duke na pamundësuar që të aplikojmë përmes platformës së e-prokurimit. *(shih foton pjesë e kërkesës/vendimit të KRPP-së faqe 1 prej 4).*

Andaj, autoritetet kontraktuese dhe Operatoret ekonomik janë te obliguar qe te ndjekin detyrimet e shënuara me poshtë lidhur me procedurat e regjistrimit ne platformën elektronike, qasjen ne sistem dhe procedurat e operimit. Operatorët ekonomik janë të obliguar të regjistrohen ne platforme dhe dorëzojnë tenderin në kopje elektronike ose fizike. por jo ne e dy versionet njëherësh. Pavarësisht nga kjo inkurajohen OE te dorëzojnë ofertat e tyre ne versionin elektronik sepse është shume me efikas dhe se shume shpejt kjo do te jete forma e vetme e dorëzimit te ofertave.
Autoritetet kontraktuese duhet të cekin në FTD të Dosjes së Tenderit, neni 19.1.h. që tenderi të dorëzohet ne njërën nga format **"në mënyrë elektronike ose fizike"(ne asnjë mënyrë me te dy versionet**). Përveç kësaj AK do ti kushtoj një vëmendje te shtuar I njoftimit ne cilën do mënyrë tjetër te OE qe te dorëzojnë ofertën elektronike për te

Pra obligim/detyrim i Autoritetit Kontraktues është që në Dosjen e Tenderit të e cek, pasi që është kërkesë administrative.

(shih foton pjesë e kërkesës/vendimit të KRPP-së faqe 2 prej 4).

Detyrimet e Autoritetit Kontraktes

Për të aplikuar platformën elektronike të prokurimit, autoriteti kontraktues ka obligimet si në vijim:

- Të regjistrohet në sistemin elektronik të prokurimit publik:
- Të bëjë publikimin e Njoftimit për Kontratë në Platformën elektronike: htpp:/leprokurimi.rks-gov.net (E njëjta do te publikohet nga KRPP edhe ne ëeb faqen e KRPP-se (mënyra e deri tanishme).
- Të vë në dispozicion për përdoruesit Dosjen e Tenderit në Platformën elektronike;
- Në Dosjen e Tenderit të ceket si kërkesë administrative, që : "Tenderi të dorëzohet në mënyrë elektronike ose në kopje fizike".

4. Poashtu pretendimi tjetër i yni ankimor është se Autoriteti Kontraktues nuk ka vë në dispozicion për përdoruesit (operatorët ekonomik) dosjen e tenderit në platformën elektronike edhe pse është e obliguar sipas Vendimit të Qeverisë së Kosovës me Nr.12/79 të datës 15.03.2016.

3. Përdorimi i proklirimit elektronik bëhet i obligueshëm për të gjitha organizatat buxhetore në Republikën e Kosovës nga data 01.01.201.7.

Meqenëse AK në ëeb-faqen e KRPP-së hapjen e ofertave për këtë aktivitet të prokurimit e ka caktuar datën 10.02.2017 ka pasur kohë ta publikoj/ngarkoj dosjen e tenderit për këtë tender në platformën elektronike.

5. Pretendimi tjetër i yni ankimor është se Autoriteti Kontraktues tek Aneksi 1 - Specifikacioni Teknik i Dosjes së tenderit tek kreu V - Elektrika në pozicionin / rreshtin 98 të tabeleës ka bërë favorizimin e produktit (ndërprerësve) AS-150A të prodhuesit **Shneider (Schneider Electric),** duke cekur kjartaz emrin e brendit e cila nuk është e lejuar, në këtë rast ka bërë diskriminimin e operatorëve ekonomik pasi që jo të gjithë mund të jenë distributor të kësaj kompanie për furnizim të produkteve të saja.

Sipas pa 20.8 të UOPP-së, Përcaktimi i specifikimeve teknike që referohen në një prodhim Specifik ose burim, ose një proces të veçantë, ose marka tregtare, patenta, lloje ose origina Specifike ose

prodhime, është si rregull i përgjithshëm i ndaluar. Megjithatë, një referencë e tillë mund të përdorët në raste të veçanta, nëse referenca e tillë përcjellët me fjalët "ose e barasvlershme/ekuivalente".

Në këtë rast AK nuk ka përdorur kërkesën tek ky pozicion për këtë produkt "e barasëlershme/ekuivalente".

(gjeni të bashkangjitur produktin sipas Ëeb-faqes zyrtare së kompanisë SCHNEIDER)

Andaj duke u bazuar në pretendimet e lartëcekura kërkojmë të anulohet vendimi i AK-së për dhënie të kontratës, dhe propozojmë që ky aktivitet i prokurimit të ANULOHET dhe i njejti të ritenderohet nëse AK ka ende interes për të.

N. 109,-Operatoret Ekonomik Ankues: N.N.T.SH. "Drini Company" sh.p.k. Prizren

Pikat e Ankesës:

NENI 7 i LPP-se - Barazia ne trajtim/ Jo - Diskriminimi

NENII 29 i LPP-se — Variantet e specifikimeve teknike

NENI 59 i LPP-se - Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve

NENI 72 i LPP-se - Dokumentacioni dhe informacioni shtese

NENI 69 i LPP-se - Aftësia teknike dhe/ose profesionale

NENI 65 i LPP-se - Provat shkresore

NENI 27 i LPP-se– Dosja etenderit

NENI 39 i Rregullave dhe UOPP-se - Sqarimi i tendereve

NENI 41 i Rregullave dhe UOPP-se - Ekzaminimi, vlerësimi dhe krahasimi i tenderëve

NENI 18 i Rregullave dhe UOPP-se - Dosja e tenderit

NENI 45 i Rregullave dhe UOPP-se - Formularet standard

Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet:

Ne me date 17.03.2017 kemi pranuar letrën për tenderuesin e pasuksesshëm për shkak çmimit me te larte. Po ne këtë date ne kemi kërkuar qasje e dokumentacionin tenderik te OE te rekomanduar për shpërblim me kontrate. Qasja na është mundësuar me date 21.03.2017 ne ora 11:30. Ne qasje ne kemi kërkuar qe te na jepet një kopje e gjithë materialit, raportin e komisionit te vlerësimit dhe korrespodencat me OE te rekomanduar për kontrate. Ne me date 22.03.2017 kemi parashtruar kërkesë për rishqyrtim pranë AK KK. Gjakove, me date 24.03.2017 është marre vendimi nga ana e AK KK. Gjakove.

Gjate e analizës te dosjes se tenderit ne kemi vërejtur se komisioni i vlerësimit te AK KK Gjakovë ka bere shkelje flagrante te dispozitave te LPP-se dhe rregullave te udhëzimit operativ për prokurim publik.

Ne vijim po ju paraqesim ne mënyrë te detajuar faktet dhe argumentet një nga një te shkelura nga

komisioni i vlerësimit te AK.

1. Ne dosje te tenderit pika 9.2. Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale

- Operatori Ekonomik duhet të dorëzoj autorizimin origjinal të prodhuesit ose dilerit për pajisje elektrike dhe trupa ndriçues.

- Operatori Ekonomik duhet të dorëzoj autorizimi e prodhuesit ose dilerit për sinjalizim horizontal dhe vertikal.

Dëshmia 4. Kërkesat ne FTD-pika 9.2.

- **Për kërkesën: autorizimi i prodhuesit apo dilerit për trupa ndriçues**

OE i rekomanduar për kontrate ka dështuar ti plotësojë këto kritere pasi qe ne dosje te tenderit nuk ka ofruar autorizim origjinal te prodhuesit apo dilerit për trupa ndriçues. Komisioni i vlerësimit ne vend se ta eliminoje me automatizëm nga konkurrenca, bënë shkelje flagrante të neni 59 te LPP-së par. 2, pasi qe pranon nga OE dokumente te cilat kane qene te kërkuara me rastin e ofertimit, ne te cilin paragraf shkruhet qarte se: ... Asnjë ndryshim material dhe asnjë aspekt i tenderit nuk duhet të kërkohen ose pranohen nga autoriteti kontraktues ose të ofrohen nga një tenderues.

Dëshmia 5. Autorizimi i cili nuk ka qene pjese e dosjes se tenderit mirëpo është pranuar me date 08.03.2017

Me këtë rast komisioni i vlerësimit i AK, ka shkelur ne mënyrë flagrante edhe neni 39 te rregullave dhe UOPP-se, pasi qe nuk i ka trajtuar ne mënyrë te barabarte te gjithë OE ofertues, sepse sipas raportit të komisionit te vlerësimit, ekzistojnë edhe OE tjerë ekonomik te cilët janë eliminuar për mungese te këtyre dokumenteve dhe te njëjtëve nuk iu është kërkuar sqarime shtese. Në këto raste komisioni i vlerësimit ka respektuar ligjin duke i bërë të papërgjegjshëm Operatoret te tjerë ekonomik (Dëshmia 6) kurse ne rastin e OE "PEVLAKU" ka kërkuar sqarime shtese, për dokumente te cilat nuk kane qene pjese e tenderit, kane pranuar te behet ndryshim material. Detyrat edhe detyrimet se ne cilat raste mund te kërkohen sqarime shtese shume mire jane specifikuar ne nenin 39 te rregullave dhe UOPP-Se. Ne këtë rast veprimi i komisionit te vlerësimit është ne kundërshtim me nenin 7 te LPP-se Barazia ne trajtim dhe jo diskriminimi.

Dëshmia 6: raporti i komisionit te vlerësimit

Gjithashtu autorizimi ne fjale edhe si i tille nuk e plotëson kushtin administrativ te dosjes se tenderit pasi qe ne piken 9.2 decitivisht është kërkuar autorizim nga prodhuesi apo distributori i autorizuar për trupa ndriçues. OE PEVLAKU ka ofruar një dokument në të cilin shkruhet se GE lighting e autorizon kompaninë ITE Group sh.p.k, nga Shqipëria e nënshkruar nga kompania VSD MERKUR Skopje, pastaj ITE group sh.p.k. e autorizon kompaninë PEVLAKU (Dëshmia 5). Në këtë rast nuk ka asnjë dëshmi se ITE Group sh.p.k. është distributor i autorizuar i kompanisë GE Lighting. Edhe kjo është një dëshmi tjetër se OE i rekomanduar për shpërblim me kontrate nuk e ka plotësuar kushtin administrativ të dosjes së tenderit, dhe njëherit ka ofruar kopje të këtij dokumenti jo ashtu siç është kërkuar në dosje te tenderit te jetë origjinal. Për këtë pike ankimore AK KK. Gjakove ne vendimin e tyre nuk e kontestojnë se kane bere shkelje pasi qe kane pranuar dokumente pas dorëzimit te tenderit mirëpo vetëm pohojnë se janë te noterizuara. Subjekt i kësaj pike ankimore është mungesa e dokumentit me rastin e ofertimit, dhe ndryshimi material i cili është bere pas sqarimeve shtese, i cili

edhe si i till nuk e plotëson kushtin administrativ.

- **Për kërkesën: Autorizimi i prodhuesit apo dilerit për sinjalizim horizontal dhe vertikal**

OE i rekomanduar për shpërblim me kontrate ne dosje te tenderit ka ofruar autorizim nga kompania IDK Konstruksion nga Shqipëria, kompani e cila merret me ndërtim dhe implementim te projekteve, nuk është as prodhuesi i komponentëve te sinjalizimit horizontale as materialeve të sinjalizimit vertikal. Mirëpo ka ofruar katalogë të produkteve nga kompani VERNISOL s.p.a. ITALI. Ne dosje te tenderit janë kërkuar dëshmi për origjinën e produkteve, ndërsa OE i rekomanduar per kontrate Pevlaku nuk ka ofruar asnjë dëshmi se produktet e sinjalizimit vertikal do te jene me standarde evropiane.

Përsëri komisioni i vlerësimit te AK, ne sqarimet e datës 08.03.2017 bene shkelje flagrante te LPP-se duke pranuar një dokument i cili as qe ishte përmendur me dosje te tenderit. Fjala është për dokumentin e lëshuar nga kompania TAMBURRINI ALESANDRO nga Italia, ku deklaron se IDK - Konstruksion është distributori ynë zyrtar. Me këtë rast komisioni i vlerësimit, ne vend se ta eliminoje nga konkurrenca si te papërgjegjshëm, ai pranon këtë ndryshim material, që është në kundërshtim me nenin 59 par.2 i LPP-së.

Dëshmia 7. Deklarata e datës 08.03.2017

Katalogët e dërguara me 13.03.2017 te prodhueseve ITALIANjanë ne gjuhen Italiane, qe është ne kundërshtim me dispozitat e LPP-se dhe UOPP pasi qe gjuha italiane nuk është gjuhe zyrtare, dhe nuk e di se si komisioni i vlerësimit i ka pranuar këto dokumente kur janë ne kundërshtim me dispozitat e LPP-se dhe se si ka arritur ta beje një vlerësim te produktit te ofruar. AK vendimin e tyre mundohen qe këto shkelje ti arsyetojnë se nuk janë kërkuar katalogë, ashtu siç u dëshmua edhe më lartë në sqarimet e datës 23.01.2017 shprehimisht janë kërkuar, katalogë. (Dëshmia 1).

Ne te njëjtën kohe ne katalogjet e ofruara ne asnjë rast nuk dëshmohet se kompania VENISOL SPA dhe TAMBURRINI ALESANDRO, janë prodhues dhe ofrojnë materiale sipas aneks 1, specifikimeve teknike te detyrueshme ne dosje te tenderit, ku ne piken 6. Sinjalizimi horizontal dhe vertikal është dhënë përshkrimi teknik se qka duhet te plotësojë ngjyra e përdorur për sinjalizim horizontal dhe folja e përdoruar për sinjalizim vertikal. OE i rekomanduar për kontrate ka ofruar vetëm katalogje te shenjave jo te materialit i cili do te përdoret.

Me katalogjet e ofruara OE i rekomanduar për kontrate nuk ka arritur ta plotësojë as minimumin e kërkesave te specifikimit teknik te detyrueshëm qe është ne kundërshtim me nenin 59 par.4 i LPP-se dhe nenin 41 te rregullave dhe UOPP-se. Ku parimet kryesore te procedurës se vlerësimit sipas LPP jane:

1. Tendetët duhet të plotësojnë substancialisht kërkesat formale administrative të specifikuara.

2. Tenderët duhet ët jenë të pranueshëm dhe duhet të përmbushin kërkesat minimale të kualifikimit (nëse janë përcaktuar).

3. Tenderët duhet të plotësojnë substancialisht kushtet obligative teknike të specifikuara.

4. Tenderët e përgjegjshëm do të vlerësohen në bazë të kritereve të specifikuara të dhënies së kontratës.

5. Vetëm kërkesat dhe kritere e dhënies së kontratës të specifikuara në njoftim për kontratë dosje të tenderit mund të përdorën si bazë për vlerësim.

6. Asnjë negocim nuk duhet të ndodhë në mes të autoritetit kontraktues dhe tenderuesve gjatë procedurës së vlerësimit, përveç komunikimeve që janë autorizuar saktësisht nga nenet 34 dhe 35 te LPP.

7. Megjithatë, vetëm sqarim i tenderëve mund të ndodhë pa ndonjë ndryshim të kushteve materiale ose aspekte të tenderit, përveç atyre te lejuara me nenin 59 che 72te LPP-Se.

8. Dhënia e kontratës do të bëhet në pajtim rigoroz me vlerësimin e kryer sipas 7 parimeve të cekura më lartë.

Pra, OE i rekomanduar për shpërblim me kontrate ka dështuar t'i përmbush kërkesat administrative sipas pikës 9.2. te dosjes se tenderit. Ndërsa komisioni i vlerësimit ka bere veprime te qëllimshme duke i shkelur te drejtat ligjore vetëm e vetëm qe me çdo kusht ta bëjnë te përgjegjshëm këtë OE.

2. Katalogu dhe certifikatat e atesteve te ofruara për trupa ndriçues.

Ne dosje te tenderit Aneks 1 - specifikimi teknik i detyrueshme pika 5. Specifikimi teknik - Elektrika (Dëshmia 8) janë paraqitur kriteret minimale që do të plotësojë një trup ndriçues si dhe certifikatat e testimit për kompatibilitet me standardet EU. OE i rekomanduar për kontratë si ne dosje te tenderit edhe ne sqarime shtese te datës 08.03.2017 dhe 13.03.2017 ka dështuar te ofroje produkt i cili i përmbush kërkesat minimale te dosjes se tenderit. Ka ofruar trup ndriçues nga prodhuesi GE lighting tipi SLBT, i cili jetëgjatësinë e llampes ndriçuese e ka > 64 000 ore, (dëshmia 9) kurse ne dosje te tenderit eshte kërkuar te jete > 100 000 ore. Kjo nënkupton se jetëgjatësia e trupit ndriçues është për 40% me e vogël se sa ajo qe është kërkuar ne dosje te tenderit.

Dëshmia 8 Kërkesat për trup ndriçues Dëshmia 9: Produkti i ofruar

Pra, OE i rekomanduar për kontrate ka dështuar ta plotësojë kërkesat minimale sipas ankes 1 te specifikimeve te detyrueshme.

Ne po te njëjtën pike te aneksit për specifikimet teknike te detyrueshme janë kërkuar: (dëshmia 8)

<u>16 | Raportet e testimit për kompatibilitet me EN cosge- (2015)</u>

<u>standardet EN (te dorëzohen me oferte)</u>

EN12352:2OOE

EN 61000-3-2

EN 62031

EN 6134.7-1

EN 61347-2-13

EN 61547

EN 62031

EN 55015

EN 62471

OE i rekomanduar për shpërblim me kontrate nuk e ka ofruar asnjë certifikate te atestimeve te cilat janë kërkuar të dorëzohen me oferte. Për me tepër, këto dokumentacione nuk janë dorëzuar as ne sqarimet e kërkuara nga komisioni i vlerësimit i AK Komuna Gjakove. Pra, AK duhet ta s'kualifikioje OE e rekomanduar për kontrate duke e zbatuar nenin 67 te Lpp-se, pasi qe sipas këtij neni OE nuk ka paraqitur prova te mjaftueshme dhe nuk i ka plotësuar kërkesat minimale te dosjes se tenderit, ku shprehimisht ne këtë nen thuhet:

Autoriteti kontraktues e s'kualifikon çdo kandidat ose tenderues që nuk paraqet: (i) certifikatat ose dëshmitë e nevojshme për të treguar ose konfirmuar se ai nuk shkualifikohet sipas nenit 65 të këtij ligji, (ii) certifikatë, dokument ose ndonjë provë tjetër të mjaftueshme që në mënyrë të arsyeshme kërkohet nga autoriteti kontraktues sipas nenit 66 të këtij ligji me qëllim të verifikimit të përshtatshmërisë profesionale të kandidatit ose tenderuesit, ose (iii) prova të mjaftueshme, sipas nenit 68 dhe 69 të këtij ligji, që në mënyrë të arsyeshme tregojnë së kandidati ose te nderuesi i plotëson kushtet minimale financiare, teknike dhe profesionale të përcaktuara në dosjen e tenderit ose në njoftimin e kontratës.

3. Katalogjet dhe autorizimet e gypave

OE i rekomanduar për kontratë ka ofruara katalogje për gypa të kanalizimit nga dy prodhues, nga FERPLAST dhe nga German PLAST (dëshmia 10). Me këtë rast për produktin e njëjtë ka ofruar varianta nga prodhues te ndryshëm, ne dosje te tenderit pika 4.1 shkruan shprehimisht qe "Variantet nuk do te autorizohen" me këtë rast komisioni i vlerësimit ka bere shkelje flagrante te nenit 29 te LPP-se, dhe kërkesave decitive te dosjes se tenderit. Përsëri komisioni i vlerësimit të AK KK. Gjakove, ne sqarimin e tyre ndaj kërkesës tone për rishqyrtim nuk e arsyeton këtë fakt të varianteve të ofruara mirëpo, bie ndesh me kërkesat e tyre duke thënë se nuk janë kërkuar katalogë.

Dëshmia 10: Katalogët për gypat e ofruar

4. Përdorimi i formularëve standard

Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë, ka bere shkelje flagrante te nenit 27 te LPP-se DOSJA E TENDERIT – dhe nenit 18, 45 te rregullave dhe UOPP-se, pasi qe OE nuk ka plotësuar formularin Standard te dorëzuar nga AK mirëpo ka e ka përvetësuar listën e çmimeve, gjë që është në kundërshtim me nenet e larte cekura pasi qe shperimisht ne këto nene shkruan:

Neni 18 i Uopp-se ...Pjesa C. Formulari për dorëzimin e ofertës, është pjesa kryesore e tenderit, sepse në kete pjese ofertuesi deklaron se ai ka kontrolluar dhe pranon te gjitha kushtete e tenderit dh dorezon oferten e tij financiare. Ajo perbehet nga:

- Formulari i tenderit

- Lista e çmimeve OE duhet te plotesoje dhe te nënshkruaj formularin (dy pjeset), sepse ne qofte se formulari nuk është plotësuar kjo do të thotë se nuk ka oferte.

Neni 32.2 i Uopp-se: ... Formulari i tenderit së bashku me të gjitha dokumentet tjera që kërkohen, të plotësuara mirë dhe të nënshkruara përbëjnë tenderin.

Neni 45 i Uopp-se

45.2 "Përdorimi i formularëve standard" këtu do të thotë se dokumentet e prokurimit duhet të përmbajnë të paktën të gjitha informatat, kërkesat, specijikimet dhe kushtet e përcaktuara në formularët standard si informacion të detyrueshëm, dhe në përgjithësi të jenë të qartë dhe të kuptueshme për OE të interesuar.

Pra, këtë e vërteton edhe raporti i komisionit te vlerësimit se OE i rekomanduar për kontrate nuk i ka plotësuar formularët standarde, mirëpo i ka ndryshuar ato. Kjo e bene te papërgjegjshëm dhe eshte ne kundërshtim me dispozitat e LPP-se

Dëshmia 6: raporti i komisionit te vlerësimit Dëshmia II: Formulari i plotësuar i OE Dëshmia 12: Formulari i dorëzuar nga AK

Në asnjë rrethanë nga nenet e lartpërmendura nuk lejohet ndryshimi i formularit standard. OE i rekomanduar per kontrate ka bere ndryshim dhe nuk e ka plotësuar atë qe është dorëzuar nga AK KK. Gjakove, pra, ky sipas neni 18 meqenëse nuk e ka plotësuar formularin duhet te llogaritet se nuk ka oferte.

5. Lista e mjeteve dhe pajisjeve,

Ne piken 9.2. te dosjes se tenderit është kërkuar

- Listën e mjetet-pajisjeve teknike të punës në dispozicion të dëshmohet me kopje të librezave mbi pronësinë e tyre, ose DUD - i doganor ose kontrata mbi qiramarrjen (listës t'i bashkëngjiten kopjet e dëshmive: librezat ose deklaratata doganore) e vërtetuar nga Operatori Ekonomik. Nëse pajisjet të cilat nuk kanë asnjë dokument duhet vërtetuar nga noteri.

OE i rekomanduar për kontratë ka dështuar të ofroj dëshmi të mjaftueshme për kapacitete profesionale dhe teknike sipas kërkesave të dosjes së tenderit.

Ne listën e mjeteve të paraqitur ne dosje te tenderit nuk Kamion te cilët i plotësojnë kushtin administrativ te dosjes se tenderit. Makina Finisher - shtresues i asfaltit, nuk është ne listën e prezantuar të makinerive, qe është në kundërshtim me kërkesat e dosjes se tenderit.

Komisioni i vlerësimit i AK, ka bere shkelje flagrante te dispozitave ligjore te LPP-se duke kërkuar sqarime shtese për plotësimin e kësaj kërkesë administrative. Ne sqarimet e date 08.03.2017, OE ka ofruar një liste mjeteve - kamionëve te regjistruara ne Shqipëri, te cilët do te angazhohen për projektin ne fjale. Komisioni i vlerësimit ka pranuar kundërligjshëm këtë ndryshim material sepse ka pranuar lista të makinerive përmes sqarimeve shtese, pas kalimit te te gjitha afateve ligjore, duke ndryshuar kushtin material te aspektit te tenderit. Për me tepër, lista e mjeteve e kamionëve te prezantuar janë me targa te Shqipërisë që ligjërisht nuk mund te operojnë dhe te punojnë ne Republikën e Kosovës. Sipas udhëzimit administrativ nr. 14/2009-MPB për regjistrimin e mjeteve, kompanitë e huaja duhet te marrin regjistrim të përkohshëm të mjeteve si dhe lejen e punës te tyre.

Ne këtë rast OE i rekomanduar për kontrate ka dështuar ta plotësojë këtë kriter sepse nuk ka ofruar dëshmi se mjetet e tyre janë te regjistruar ne KOSOVE dhe mund te operojnë konform ligjeve dhe rregullave te Republikës te Kosovës.

Dëshmia 13. Lista e pajisjeve e dorëzuar me date 08.03.2017

Pra, me ketë rast komisioni i vlerësimit, ka shkelur dispozitat ligjore dhe kërkesat e dosjes se tenderit duke kërkuar sqarime shtese per lista te cilat nuk kane qene pjese e dosjes se tenderit, mirëpo edhe pas ofrimit kundërligjshëm OE nuk e plotëson kete kusht pasi qe mjetet ne dispozicion nuk mund te operojnë konform ligjeve te Kosoves dhe i njëjti përkundër këtyre shkeljeve ka shpallur të përgjegjshme një kompani e cila nuk ka ofruar dëshmi për kapacitet te mjaftueshme profesionale dhe teknike.

6. Origjina e produkteve te ofruara

OE i rekomanduar për kontrate ka dështuar qe ne dosje te tenderit te ofroje dëshmi për origjinën e produkteve te ofruara.

Ne dosje te tenderit dhe ne sqarime shtese OE ka dështuar te ofroje dëshmi për origjinën e produkteve, kubëza, skajorë dhe elemente tjera betoni, **Nuk ka ofruar as certifikata e as katalogë për këto produkte.** Edhe ne këtë rast AK KK. Gjakove ne sqarimin e tyre deklaron qe sipas komisionit te vlerësimit eshte ne rregull dhe i plotëson kushtet, mirëpo gjendja faktike dhe materiale sipas kërkesave të dosjes së tenderit, eshte krejt e kundërta. Ne FTD dhe ne specifikimet teknike te detyrueshme jane kërkuar qe te gjitha produktet te jene me standarde Evropiane dhe te ofrohen katalogë, **ne kete rast nuk kane ofruar asnjë dëshmi, se përmbushet ky kusht.**

OE i rekomanduar për kontrate është i papërgjegjshëm, pasi qe nuk i ka plotësuar kërkesat minimale administrative dhe teknike profesionale të dosjes së tenderit.

Nga te gjitha faktet e lartpërmendura kërkojmë nga OSHP qe ta aprovoje ankesën tone si te bazuar dhe lenden ta ktheje ne rivlerësim. Pasi qe janë te evidentuara shkelje flagrante te dispozitave ligjore te LPP-se, dhe i njëjti OE ka dështuar qe t'i plotësojë kërkesat minimale te dosjes se tenderit.

Procesi i prokurimit

Data e autorizimit të prokurimit nga zyrtari autorizues (N. 22.1)..... 21.12.2016

Data e njoftimit për kontratë (N. 40) 29.12.2016

Lloji i procedurës së aplikuar (N.33-38):-.....Procedura e hapur

Lloji dhe vlera e kontratës së publikuar(N.16): .....Punë /e Madhe

Vlera e përllogaritur për këtë prokurim (N.15-19): ..... 703,916.18 €

Data e hapjes së ofertave:..... 10.02.2017

Data e njoftimit të Dhënies së Kontratës në faqen e KRPP-së.....17.03.2017

Kriteret për vlerësim

- III.2.1)Kërkesat e përshtatshmërisë:

- Operatori Ekonomik duhet ti përmbushë kërkesat e specifikuara në nenin 65 të Ligjit të Prokurimit Publik (LPP).
- Vërtetim nga Administrata Tatimore e Kosovës.
- Vërtetim nga Gjykata kompetente.

- *Dëshmia e kërkuar dokumentare:*

- Një deklaratë nën betim e nënshkruar nga tenderuesi duke përdorur formularin në Aneksin 2.
- Një vërtetim i nënshkruar nga Administrata Tatimore e vendit të themelimit të Operatorit Ekonomik,se Operatori Ekonomik në fjalë nuk është me vonesë për pagimin e tatimeve së paku deri në tremujorin e fundit të vitit para dorëzimit të tenderit (vlen për OE fitues).
- Një dokument nga Gjykata kompetente ku dëshmon se Operatori Ekonomik nuk është i falimentuar ose likuiduar (Kërkohet origjinali ose kopja e vërtetuar, vlen për OE fitues).

- III.2.2)Përshtatshmëria profesionale:

- Regjistrimi si Operator Ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe/apo regjistrin e ndërmarrjeve në vendin e juaj të themelimit
- Certifikata e Numrit Fiskal
- Certifikata për Regjistrim në TVSH e lëshuar nga ATK

- *Dëshmia e kërkuar dokumentare:*

- Certifikata e regjistrimit të biznesit (kopje).
- Certifikata e numrit fiskal (kopje).
- Certifikata për regjistrim në TVSH (kopje).

- III.2.3)Kapaciteti ekonomik dhe financiar

- Operatori Ekonomik duhet të ketë një qarkullim financiar bankar me një vlerë të përgjithshme prejsë paku 1.400.000,00€, në tre vitet e fundit (2013,2014,2015).

- *Dëshmia e kërkuar dokumentare:*

- Vërtetimi nga banka ose raport bankari nënshkruar dhe vulosur i cili dëshmon se qarkullimi bankar i kërkuar në periudhën e tri viteve të fundit është i plotësuar sipas kërkesës.

- III.2.4) Kapaciteti teknik dhe profesional

- Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka përfunduar me sukses kontrata të natyrës së njëjte në 3 (tri) vitet e fundit (së paku tri).

- Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se ka ose mund të angazhoj staf të mjaftueshëm për kryerjen e projektit,dhe:
- një inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë - drejtimi konstruktiv
- një inxhinier i diplomuar i ndërtimtarisë - drejtimi hidroteknik
- një inxhinier i diplomuar i elektroteknikës
- një gjeodet

- Operatori Ekonomik duhet të ofrojë dëshmi se kanë dispozicion ose kontratë mbi qiramarrjen për këto mjete-pajisje teknike për realizimin e kontratës siç janë:

- 2 ekskavator,
- 4 kamionë kiper,
- 2 cilindra,
- 1 grejder,
- 1 finisher

- Autorizimin origjinal i prodhuesit ose dilerit për pajisje elektrike dhe trupa ndriçues.
- Autorizimi e prodhuesit ose dilerit për sinjalizim horizontal dhe vertikal.
- Të gjitha produktet duhet të jenë me standarde Evropiane (te specifikuara ne annex 1 – specifikimet teknike te detyrueshme), - të ofrohen certifikata për origjinën e produkteve të ofruara.
- Garancioni nga prodhuesi dhe ofertuesi veq e veq, - Për produktet e specifikuara ne annex 1 - specifikimet teknike të detyrueshme.
- Prodhimet (prodhuesi) duhet të jene të certifikuara me EN ISO 9001.
- Certifikatën ISO 9001.
- Certifikatën ISO 39001:2012 (Road traffic safety management system).
- Certifikata EN dhe protokolle të testimit për produktet e ofruara – sipas annex 1 - specifikimet teknike të detyrueshme.
- Plani dinamik jo më shumë se 100 ditë kalendarike.

Dëshmia e kërkuar dokumentare

- Listën e kontratave në të cilën specifikohen të gjitha projektet punuese dhe aktivitete e ndërtimit të Operatorit Ekonomik të realizuara në tri vitet e shkuara, duke saktësuar punët e kryera, shumën e kontratës, datën dhe pranuesit ose certifikatën e ekzekutimit te mire te punëve - (së paku tri, te cilat përputhen secila kontratë me referencë ose raport pranimit).

- Listën e kualifikimeve shkollore dhe profesionale të personelit tuaj udhëheqës dhe fuqisë tjetër punëtore duke e dëshmuar me diploma dhe kontrata të punës. Nëse anëtarët e stafit nuk janë në marrëdhënie pune te Operatori Ekonomik, atëherë duhet dorëzuar kontratën për projektin në fjalë (të dëshmohet me një Deklaratë që Operatori Ekonomik i ka të punësuar ose mund ti angazhoj staf për kryerjen e punëve me sukses,e vulosur dhe nënshkruar nga Operatori Ekonomik).

- Listën e mjetet-pajisjeve teknike të punës në dispozicion të dëshmohet me kopje të librezave mbi pronësinë e tyre , ose DUD – i doganor ose kontrata mbi qiramarrjen (listës t'i bashkëngjiten kopjet e dëshmive: librezat ose deklaratat doganore) e vërtetuar nga Operatori Ekonomik. Nëse paisjet të cilat nuk kanë asnjë dokument duhet vërtetuar nga noteri.

- Operatori Ekonomik duhet të dorëzoj autorizimin origjinal të prodhuesit ose dilerit për pajisje elektrike dhe trupa ndriçues.

- Operatori Ekonomik duhet të dorëzoj autorizimi e prodhuesit ose dilerit për sinjalizim horizontal dhe vertikal.

- Operatori Ekonomik duhet të prezantoj se të gjitha produktet janë me standarde Evropiane (te specifikuara ne annex 1 – specifikimet teknike të detyrueshme), - të ofrohen certifikata për origjinën e produkteve të ofruara.

- Operatori Ekonomik duhet të dorëzoj garancionin nga prodhuesi dhe ofertuesi veq e veq, - Për produktet e specifikuara ne annex 1 - specifikimet teknike te detyrueshme(vlen për OE fitues).

- Operatori Ekonomik për të gjitha prodhimet (prodhuesi) duhet të jenë të certifikuara me EN ISO 9001(vlen për OE fitues).

- Operatori Ekonomik duhet të ketë certifikatën ISO 9001

- Operatori Ekonomik duhet te ketë certifikatën ISO 39001:2012 (Road traffic safety management system) (vlen për OE fitues).

- Operatori Ekonomik duhet të prezantoj certifikata EN dhe protokolle të testimit për produktet e ofruara – sipas annex 1 - specifikimet teknike të detyrueshme (vlen për OE fitues).

- Plani dinamik i nënshkruar dhe i vulosur jo më shumë se 100 ditë kalendarike.

Regjistri i ofertuesve sipas procesverbalit të hapjes publike:

Nr.	Emri i OE	Vendi	Çmimi
1.	N.N.T.SH. "Drini Company"	Prizren	688,777.59 €
2.	"Pe-Vla-Ku" sh.p.k.	Prishtinë	587,885.79 €
3.	"Jos Krasniqi-Bazë" sh.p.k.	Junik	542,532.68 €
4.	"Lika Trade" sh.p.k.	Deçan	526,527.14 €
5.	"Fidani -L" & "Renelual Tahiri" sh.p.k.	Babaloç	556,130.04 €
6.	"Veha Group" sh.p.k. & "Global" sh.p.k.	Prizren	563,511.67 €
7.	"Euroasphalt" sh.p.k.	Gjakovë	488,528.23 €
8.	N.P.N."Valbona-G2" dhe "Benita Company"	Llugagji	507,506.57 €
9.	"Victory Com" & "Burimi"	Gjakovë	585,850.25 €

Sipas Procesverbalit të Hapjes së Tenderëve konstatohet se në hapjen e ofertave kanë marrë pjesë përfaqësuesit e 7 (shtatë) OE, ku është lexuar emri i operatorit ekonomik, vendi dhe çmimi.

Komisionet vlerësues pran AK

Përbërja dhe kualifikimi i komisionit vlerësues (N. 59).

Autoriteti kontraktues, me dt. 13.02.2017, ka caktuar komisionin për vlerësimin e tenderëve në përbërje prej 3 (tre) anëtarëve, si në vijim:

- Nexhip Qehaja, Inxhinier i Ndërtimtarisë, Kryesues
- Lekë Sina, Inxhinier i Komunikacionit, Anëtar
- Ilhamije Kumnova, Inxhinier e elektroteknikes, Anëtare
- Korab Shehu, Inxhinier i Komunikacionit, Monitorues

Data e mbarimit të vlerësimi:..... .17.03.2017

Data e vendimit të AK-së mbi refuzimin e kërkesës për rishqyrtim të OE "Lika Trade" sh.p.k. – Deçan, OE "Euroasphalt" sh.p.k .- Gjakovë dhe OE NNTSH "Drini Company" sh.p.k. Prizren (N. 108/A):.....15.03.2017 dhe 24.03.2017.

Raporti i komisionit vlerësues

Bazuar në raportin e vlerësimit të tenderëve, komisioni vlerësues konstatoj se 9 (nëntë) operator ekonomik që kanë ofertuar, ne aktivitetin e prokurimit **"Ndërtimi i rrugës Bujar Roka – pjesa jugore e qytetit në Gjakovë"**, me nr. të prokurimit: 632/16/081/511, 2 (dy) operator ekonomik i plotësojnë kriteret e përzgjedhjes të kërkuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë, ndërsa 7 (shtatë) operator ekonomik janë të pa përgjegjshëm pasi që nuk ka plotësuar kriteret e përzgjedhjes të kërkuara në dosjen e tenderit dhe në njoftimin për kontratë.

- OE-Konzorcium N.SH.T. "VIKTORY COM & N.N.T. BURIMI" Gjakovë, nuk është dorëzuar autorizim origjinal i prodhuesit ose dilerit për pajisjet elektrike dhe trupa ndriçues, ashtu siç është kërkuar në pikën 9.2. të FTD-së. Nuk është dorëzuar autorizim i origjinal i prodhuesit ose dilerit për sinjalizim horizontal dhe vertikale, ashtu siç është kërkuar në pikën 9.2. të FTD-së. Nuk është dorëzuar dëshmi për produkte se janë standarde evropiane, ashtu siç është kërkuar në pikën 9.2. të FTD-së. Nuk është dorëzuar garancioni 12 muaj ashtu siç është kërkuar në sqarimet e dt. 23.01.2017. Pjesa C. Formulari i dorëzimit të tenderit, nuk është plotësuar pika 7 e këtij formulari nuk është deklaruar udhëheqësi i konsorciumit. Aneksi 2: Deklarata nën Betim, nuk është shënuar emri i OE që paraqitet N.SH.T. "VIKTORY COM". Aneksi 2: Deklarata nën Betim, nuk është shënuar emri i OE që paraqitet N.N.T. "BURIMI". Pjesa 2: Paramasa dhe parallogaria- Nuk është plotësuar formulari standard i dorëzuar me dosjen e tenderit. Mos plotësimi i formularëve standard është në kundërshtim me nenin 18. Pjesa C te Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimi Publik, si dhe me nenin 45. Formulari standard. Sigurimi i tenderit nuk është dorëzuar ne origjinal.

- OE-Konzorcium N.N.P. "VALBONA-GJ"& "BENITA COMPANY" SH.P.K Llugagji, plani dinamik për kryerjen e punimeve nuk është ofruar ashtu siç është kërkuar ne dosjen e tenderit, në piken 9.2 te FTD. Në dosje është kërkuar 100 ditë kalendarike. Ju keni paraparë ne planin dinamik 20 javë që në total janë 140 ditë kalendarike, vete kanë deklaruar se një javë do ti ketë 5 ditë pune. Nuk keni marrëveshje për vitin 2017 me gjeldetin. Pjesa 2: Paramasa dhe parallogaria- Nuk është plotësuar formulari standard i dorëzuar me dosjen e tenderit. Mos plotësimi i formularëve standard është në kundërshtim me nenin 18. Pjesa C te Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimi Publik, si dhe me nenin 45. Formulari standard. Ju nuk keni ofruar dëshmi të mjaftueshme për makineri finisher ashtu siç është kërkuar në 9.2 te FTD-së. në dosje është kërkuar që te dëshmohet me libreza ose DUD, ju keni ofruar vetëm faturë të blerjes, dhe i njëjti nuk gjendet ne listën e pajisjeve. OE ka ofruar autorizim nga ndërmarrja "MALSIJA" e cila ka ofruar autorizim (nuk është diler i autorizuar nga 3M) nga kompania 3M për një projekt tjetër të Bashkimit Evropian, ku autorizim nuk është lëshuar për këtë projekt.

- OE "EUROASPHALT" Gjakovë, plani dinamik për kryerjen e punimeve nuk është ofruar ashtu siç është kërkuar ne dosjen e tenderit, në piken 9.2 te FTD. Në dosje është kërkuar 100 ditë kalendarike. Ju keni paraparë ne planin dinamik 20 javë që në total janë 140 ditë kalendarike. Aneksi 2: Deklarata nën Betim, nuk është shënuar emri i OE që paraqitet. Pjesa 2: Paramasa dhe parallogaria- Nuk është plotësuar formulari standard i dorëzuar me dosjen e tenderit. Mos plotësimi i formularëve standard është në kundërshtim me nenin 18. Pjesa C te Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimi Publik, si dhe me nenin 45. Formulari standard. Në listën e punëtorëve ka prezantuar staf i cili është në marrëdhënie të rregullt pune edhe ne KK Gjakovë, kjo përbën konflikt interesi pasi që ne kontratë i njëjti do të angazhohet ne të gjitha projektet e kompanisë "EUROASPHALT", nga periudha 01.05.2015-01.05.2017. Në listën e pajisjeve ka prezantuar grejder i cili nuk është dëshmuar me libreza ose DUD ashtu siç është kërkuar në dosje te tenderit. Kompania ITK e cila e autorizon OE "EUROASPHALT", nuk ka dëshmuar se është distributor i autorizuar për sinjalizim horizontal (për sinjalizim vertikal ka dëshmuar se është distributor i autorizuar). OE EUROASPHALT", ka prezantuar një deklaratë se punët e ujësjellësit do te kryhen nga kompania "ALFA-i", i njëjti nuk ka asnjë marrëdhënie kontraktuale si anëtar i konzorciumit apo i deklaruar si nënkontraktor.

- OE "VEHA GROUP"& "GLOBAL" Prizren, kopjet nuk duket te jene identike me origjinalin për nga numri i faqeve. Pjesa 2: Paramasa dhe parallogaria- Nuk është plotësuar formulari standard i dorëzuar me dosjen e tenderit. Mos plotësimi i formularëve standard është në kundërshtim me nenin 18. Pjesa C te Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimi Publik, si dhe me nenin 45. Formularët standard. Nuk ka ofruar autorizim të prodhuesit apo te dilerit të autorizuar për sinjalizim horizontal dhe vertikal, ka vetëm marrëveshje për shfrytëzim të mjeteve me kompaninë "LIMIT". Nuk ka ofruar autorizim të prodhuesit apo dilerit të autorizuar për pajisje elektrike dhe trupa ndriçues, ka ofruar vetëm marrëveshje për shfrytëzimin e mjeteve me kompaninë "Multi Bussines Group". Pajisjet makineriek nuk janë ne listë por janë me marrëveshje me "KAG Asfat". 3 (tre) kamion me regjistrim, 1 (një) nuk ka regjistrim. Grejderi nuk është ne listë. Nuk ka ofruar dëshmi për produktet se janë me standarde evropiane.

- OE N.T.P "FIDANI-L"& "RENALUAL TAHIRI" Sh.P.K. Babaloç, Aneksi 2: Deklarata nën Betim, nuk është shënuar emri i OE që paraqitet "FIDANI-L". Pjesa 2: Paramasa dhe parallogaria- Nuk është plotësuar formulari standard i dorëzuar me dosjen e tenderit. Mos plotësimi i formularëve standard është në kundërshtim me nenin 18. Pjesa C te Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimi Publik, si dhe me nenin 45. Formularët standard.. "BOJA D.o.o. e autorizon kompaninë "LIMIT" i cili me pastaj autorizon OE tenderues që ne këtë rast "LIMIT" nuk është distributor i autorizuar për sinjalizim horizontal dhe vertikal. Nuk ka autorizim për pajisje elektrike dhe trupa ndriçues. Nuk ka dëshmi për origjinës e produkteve të ofruara. Gjeodeti nuk është në liste dhe nuk ka kontrate.

- OE "LIKA TRADE" Sh.P.K Deçan, plani dinamik për kryerjen e punimeve nuk është ofruar ashtu siç është kërkuar ne dosjen e tenderit, në piken 9.2 te FTD. Në dosje është kërkuar 100 ditë kalendarike. Ju keni paraparë ne planin dinamik i cili fillon me dt. 05.02.2017 deri me dt. 25.06.2017, qe në total janë 140 ditë kalendarike d.m.th. e keni tejkaluar kërkesat e AK. Në pikën 9.2 të dosjes së tenderit-përshtatshmëria profesionale janë kërkuar dëshmi te cilat do të dorëzohen me rastin e ofertimit. OE "LIKA TRADE" ka dështuar që të ofroj dëshmi të përshtatshmërisë sipas kërkesave te dosjes së tenderit. Vetëm deklarate nëse fitoj. Pjesa 2: Paramasa dhe parallogaria- Nuk është plotësuar formulari standard i dorëzuar me dosjen e tenderit. Mos plotësimi i formularëve standard është në kundërshtim me nenin 18. Pjesa C te Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimi Publik, si dhe me nenin 45. Formularët standard.

- OE "JOOS& KRASNIQI-BAZE" Sh.P.K. Junik, plani dinamik për kryerjen e punimeve nuk është ofruar ashtu siç është kërkuar ne dosjen e tenderit, në piken 9.2 te FTD. Në dosje është kërkuar 100 ditë kalendarike. Ju keni paraparë planin dinamik për përfundimin e punëve 100 ditë pune. Deklarata nën Betim është dhënë duke u mbështetur në nenin 65 të Ligjit të vjetër të Prokurimit Nr. 04/L042, jo ashtu siç është kërkuar ne dosjen e tenderit me ligjin Nr. 04/L-042 i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-237, Ligjin Nr. 05/L-068 dhe Ligjin 05/L-092, edhe vet hartimi i kësaj dosje është krijuar mbi këtë të fundit. Pjesa 2: Paramasa dhe parallogaria- Nuk është plotësuar formulari standard i dorëzuar me dosjen e tenderit. Mos plotësimi i formularëve standard është në kundërshtim me nenin 18. Pjesa C te Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimi Publik, si dhe me nenin 45. Formularët standard. Kompania Disano e ka autorizuar "KBIESSE", ky ka marrëveshje me "JOOS KRASNIQI". Kompania"JOOS KRASNIQI" ka marrëveshje me "RSM", ky ka prezantuar produkte te kompanive si "NOUVA MARIC SRL dhe TAMBURINI ALESSABDRO" që janë furnizues i "RSM-së".

- OE "PEVLAKU" Sh.P.K. Prishtinë, kamionët e prezantuar nuk janë në listën e pajisjeve dhe janë me targa të Shqipërisë. Kamioni i prezantuar i Kosovës me regjistrim të skaduar, gjendet në listën e prezantuar. Finisheri nuk është në listë, është me marrëveshje te qiramarrjes. Nuk ka dëshmi se IDK, është diler i autorizuar nga kompania italiane "Tamburini alesandro srl" për sinjalizim vertikal. Nuk ka dëshmi që IDK është diler i autorizuar për sinjalizim horizontal. Ka ofruar trupa ndriçues te GE elektrik, nga i njëjti nuk ka asnjë autorizim apo nga përfaqësuesi i autorizuar. Pjesa 2: Paramasa dhe parallogaria- Nuk është plotësuar formulari standard i dorëzuar me dosjen e tenderit. Mos plotësimi i formularëve standard është në kundërshtim me nenin 18. Pjesa C te Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimi Publik, si dhe me nenin 45. Formularët standard.

Pas sqarimeve shtesë 07.03.2017, OE ka ofruar dëshmi të mjaftueshme krahasuar me ato të kërkuara. Ne sqarimet e dt. 10.03.2017, OE (vlen për OE fitues) ka ofruar dëshmi të mjaftueshme në bazë të kërkesave tona. Ne sqarimet e dt. 14.03.2017, OE ka ofruar dëshmi të mjaftueshme për origjinalitetin e dokumentacionit.

- OE "DRINI" Prizren, sqarime shtesë për distributor të autorizuar -3M. Pas sqarimeve shtesë të dt. 07.03.2017, OE ka ofruar dëshmi të mjaftueshme.

Sipas rekomandimit të komisionit të vlerësimit nga 9 (nëntë) operatoret ekonomik, 2 (dy) ishin të përgjegjshëm, "PE-VLA-KU"sh.p.k. dhe NNTSH "DRINI COMPANY" shpk.
OE "PE-VLA-KU"sh.p.k. Prishtinë, është me çmimin me të ulët dhe më i përgjegjshëm dhe komisioni i vlerësimit e rekomandon për kontratë.

Analiza dhe konstatimet e ekspertit shqyrtues (N. 113,114)

Në finalizim të analizimit dhe shqyrtimit të Lëndës Tenderime, është konstatuar, si në vijim:

Sqarimi: Nr. 1 (mbarëvajtja e procedurës së prokurimit).

Ekspertja shqyrtues bazuar ne dokumentacioni që ka në shqyrtim konstaton se autoriteti kontraktues në aktivitet të prokurimit "**Ndërtimi i rrugës Bujar Roka – pjesa jugore e qytetit në Gjakovë**", me nr. të prokurimit: 632/16/081/511, ka aplikuar procedurën hapur. Lloji i kontratës është kontratë publike, punë, vlerë e madhe. Dosja e tenderit përfshinë termet dhe kushtet materiale të saja, procedurën e zbatueshme të prokurimit, kërkesat të aplikueshme të përshtatshmërisë dhe kriteret e përzgjedhjes.

Sqarimi: Nr. 2

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues **"Lika Trade" sh.pk. Deçan**, ku thuhet se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 59 të LPP-së, respektivisht ku ceket: "*Plani dinamik për kryerjen e punimeve është ofruar konform kërkesë së AK-se prej 100 ditëve kalendarike. Mund të shihet qartë se shkruan me ngjyrë te theksuar numri i ditëve (100days) qe kemi ofruar për kryerjen e punëve. Ndërsa llogaritja e AK-se në bazë të pozicioneve (aktiviteteve) është komplet e gabuar dhe jo profesionale pasi që ne realizimin e një projekti, përkatësisht një rruge bëhen disa pozicione (aktivitete) të ndryshme brenda ditës dhe që në total rezulton me numrin e ofruar prej 100 ditëve për të cilin prapë zotohemi se do ta realizojmë projektin*", ekspertja shqyrtues sqaron, operatori ekonomik ankues ka ofruar planin dinamik për kryerjen e punëve, prej dt. 05 shkurt 2017 deri me dt. 25 qershor 2017, apo ka dhenë edhe përshkrimin e punëve që do të kryhen, duke specifikuar si në vijm: Rruga 50 ditë; Kanalizimi atmosferik 20 ditë; Kanalizimi fekale 20 ditë; Ujësjellësi 25 ditë; Elektrika 25 ditë; Sinjalizimi horizontal dhe vertikal 10 ditë dhe Dislokimi i instalimeve të ngrohjes 30 ditë.

Bazuar ne atë që u tha më lartë, rezulton se operatori ekonomik ankues nuk e ka ofruar palnin dinamik ashtu siç është kërkuar në nenin 9.1 dhe 9. 2 në FTD, ku thuhet: "*Plani dinamik i nënshkruar dhe i vulosur jo më shumë se 100 ditë kalendarike*".

Sqarimi: Nr. 3

Lidhur me arsyen e dytë të eliminimit të dhënë nga autoriteti kontraktues, për operatorin ekonomik ankues **"Lika Trade" sh.pk. Deçan,** ku thuhet: *"Nuk keni prezantuar autorizimet nga prodhuesit apo dileri i autorizuar për pajisje elektrike, trupa ndriçues, sinjalizim horizontal dhe vertikal"*, ekspertja shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues në nenin 9.1 dhe 9.2 të FTD-së, te kërkesat mbi mundësit teknike dhe profesionale ka specifkur kërkesën ku thuhet: *"Autorizimin origjinal i prodhuesit ose dilerit për pajisje elektrike dhe trupa ndriçues; Autorizimi e prodhuesit ose dilerit për sinjalizim horizontal dhe vertikal"*, ndërsa operatori ekonomik ankues nuk ka ofruar dëshmi konform kërkesës së lartë cekur, por Deklaratë per dokumetete që do të dorëzohen në rast se shpallën fitues, ku deklaron se në rast së shpallet fitues do të dorëzoj *"Autorizimi e prodhuesit ose dilerit për sinjalizim horizontal dhe vertikal"*.

Ndërsa sa i përket asaj ku thuhet: *"Ne piken 9.2. te dosjes se tenderit - përshtatshmëria profesionale nuk është e vërtete qe janë kërkuar nga AK dëshmi të cilat do te dorëzohen me rastin e ofertimit. Janë kërkuar për fituesin dhe është cekur (vlenë për OE fitues). Gjithashtu janë RI-SQARUAR se VLENË PER OE FITUES, ne letrën për sqarime te dërguar nga Autoriteti kontraktues (Komuna e Gjakoves) me datën 23.01.2017"*, ekspertja shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues në dosjen e tenderit dhe në sqarimet e dt. 23 janar 2017, ka specifikuar qartë cilat kriteret te kërkesat mbi mundësit teknike dhe profesionale janë obligative të dorëzohet nga tenderuesit me ofertë dhe cilat vlejnë vetëm për fituesin.

Sqarimi: Nr. 4

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues **"Euroasphalt" sh.p.k .- Gjakovë,** ku thuhet: *"Autoriteti Kontraktues ka kërkuar tek Kërkesat mbi mundësitë teknike dhe/ose profesionale pozicioni 9.1 i FDT-së "**AUTORIZIMIN e prodhuesit ose dilerit** për Sinjalizim Horizontal dhe Vertikal" ku si dëshmi pra është kërkuar në pozicionin 9.2 të FDT-së "Operatori Ekonomik duhet të dorëzoj autorizimin e prodhuesit apo dilerit për sinjalizim horizontal dhe vertikal", me çrast Operatori Ekonomik "PE-VLA-KU" SH.P.K - Dega në Kosovë ka dorëzuar dy dokumente nga kompanitë prodhuese. **VERNISOL** për sinjalistikë horizontale dhe nga kompania prodhuese **TAMBURRINI ALESSANDRO** për sinjalistikë vertikale, që të dya kompani ITALIANE, ku që të dya dokumente i janë lëshuar kompanisë **IDK-KONSTRUKTION** me seli në Shqipëri të cilat dokumente nuk janë **AUTORIZIM** dhe nuk kanë përmbajtjen e as titullin si **AUTORIZIMI**, ku dokumentet janë të ndarë në dy tabela, ku në anën e majtë prezantohet dokumenti si **DICHTARAZIONE** në gjuhën italiane dhe përmbajtja është në gjuhën italiane dhe në anën e djathtë të dokumentit prezantohet përkthimi në gjuhën shqipe si **DEKLARATË**, pra që të dya dokumente dmth thjeshtë janë deklarata dhe nuk mund të konsiderohen si AUTORIZIME"*, ekspertja shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues në nenin 9.1 dhe 9.2 të FTD-së, te kërkesat mbi mundësit teknike dhe profesionale ka specifkur kërkesen ku thuhet: *"Autorizimi e prodhuesit ose dilerit për sinjalizim horizontal dhe vertikal"*, ndërsa operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës lidhur me kërkesën në fjalën në ofertë ka ofruar si dëshmi Autorizim nga dileri i autorizuar- "I.D.K. KONSTRUKSION" Tiranë.

Lidhur e pretendimin e operatorit ekonomik ankues të cekur me lartë, ekspertja shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues me dt. 07.03.2017, konform nenit 72 të LPP-së, ka adresuar te operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë-Kërkesë për dokumentacion dhe informata shtesë, ku thuhet: Nuk keni ofruar dëshmi së IDK është diler i autorizuar nga kompanai italiane *TAMBURRINI ALESSANDRO për sinjalistikë vertikale, si dhe nuk keni ofruar dëshmi se IDK eshte diler i autorizuar për sinalistik horizontale.*

Ekspertja shqyrtues sqaron se operatorit ekonomik i rekomanduar për kontratë, me dt. 08 mars 2017, ka dorëzuar në autoritet kontraktues Deklaratë në lëshuar nga "VERNISOL" Itali, ku ndër të tjera thuhet: shoqëria "IDK KONSTRUKSION" shpk Tiranë, është distributor zyrtarë i yni për "Bojra dhe aksesor për sinjalitik rrugore horizontale". Po ashtu, edhe nga kompanai italiane "*TAMBURRINI ALESSANDRO*" ka ofruar Deklaratë ku ceket: shoqëria "IDK KONSTRUKSION" shpk Tiranë, është distributor zyrtarë i yni për "Sinjalistiken rrugore vertikale dhe aksesoreve të ndryshem".

Sqarimi: Nr. 5

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues **"Euroasphalt" sh.p.k .- Gjakovë,** ku thuhet: *"OE "PE-VLA-KU" SH.P.K ka vendosur certifikata të saja për ISO standarde, dhe ka vendosur certifikata të ISO standardeve për **GERMAN PLAST** me seli në Junik, për produktet e gypave për ujësjellës nuk egzistojnë certifikatat e EN dhe as protokoll raporte të testimit (analizave) për këto produkte, prodhuesi vendor ka prezantuar vetëm certifikatat e ISO standardeve"*, ekspertja shqyrtues sqaron se qëndron pretendimi i operatorit ekonomik ankues, për arsye se operatori ekonomik i rekomanduar për dhënie të kontratës ka ofruar si dëshmi certifikata të ISO standardeve për "GERMAN PLAST", për gypa të ujësjellësit bashkangjitur katalogun "GERMAN PLAST", ndërsa në FTD në nenin 9.2 eshte specifikuar qarte se duhet të ofrohen si dëshmi: Operatori Ekonomik duhet të prezantoj certifikata EN dhe protokolle të testimit për produktet e ofruara – sipas annex 1 - specifikimet teknike të detyrueshme (vlen për OE fitues).

Sqarimi: Nr. 6

Pretendimi i operatorit ekonomik ankues **"Euroasphalt" sh.p.k .- Gjakovë** ku thuhet: *"Autoriteti Kontraktues Komuna Gjakovë përkatësisht zyra e prokurimit nuk e ka rrespektuar vendimin e KRPP-së lidhur me zbatimin e platformës së e-prokurimit nr.112/2016 të datës 31.08.2016, duke mos e cekur / plotësuar - sqaruar tek pozicioni 19.1 (h) e FDT-së (dosjes së tenderit) që tenderi duhet të dorëzohet në njërën nga format "në mënyrë elektronike ose fizike" (në asnjë mënyrë në të dy versionet), me çrast neve si operator ekonomik na ka shkaktuar probleme duke na pamundësuar që tët protokolit aplikojmë përmes platformës së e-prokurimit "*, ekspertja shqyrtuese sqaron KRPP-ja, përmes Kërkesës lidhur me zbatimin e platëformës elektronike, me nr. 112/2016, të dt. 31.08.2016, ka kërkruar nga të gjitha autoriteti kontaktuese në nivelin qendror që të fillojnë përgatitjet intensive për aplikimin e platëformës nga data e cekur me lartë.

Ndërsa për mes vendimit të KRPP-së, me nr. 47/2016, të dt. 01.12.2016, pëdorimi i prokurimit elektronik bëhet i obligushem për të gjitha organizatat buxhetore te nivelit lokla dhe ndërmarrjet publike nga data 01.01.2017.

Ekspertja shqyrtuese bazuar në faktin se njoftimi për kontratë është publikuar me dt. 29.12.2016, si dhe në atë që u tha me lartë sqaron se autoriteti kontraktues nuk ka vepruar ne kundërshtim me Këkreën e KRPP-së nr. 112/2016, të dt. 31.08.2016, dhe ne vendimin e KRPP-së, me nr. 47/2016, të dt. 01.12.2016.

Sqarimi: Nr. 7

Pretendimi i operatorit ekonomik ankus **"Euroasphalt" sh.p.k . Gjakovë,** ku thuhet se autoriteti kontraktues ka bërë shkleje të nenint 28 të LPP-së respektivisht aty ku ceket : "*Autoriteti Kontraktues tek Aneksi 1 - Specifikacioni Teknik i Dosjes së tenderit tek kreu V - Elektrika në pozicionin / rreshtin 98 të tabeleës ka bërë favorizimin e produktit (ndërprerësve) AS-150A të prodhuesit **Shneider (Schneider Electric),** duke cekur kjartaz emrin e brendit e cila nuk është e lejuar, në këtë rast ka bërë diskriminimin e operatorëve ekonomik pasi që jo të gjithë mund të jenë distributor të kësaj kompanie*

për furnizim të produkteve të saja", bazuar ne Aneksin 1-Specifikimin teknike të detyrushem, ekspertja shqyrtuese sqaron se ne pozicionin 98, autoriteti kontraktues ka specifikuar si në vjim: *Furnzimi i transporti montimi i ndërprerësve AS-150A-Shneider*, që nënkupton se në rastin konkret autoriteti kontraktues ka cekur emrin e prodhuesit, që është ne kundërshtim me nenin 28 paragrafi 7 të LPP-së dhe nenin 20.8, Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik-A01.

Sqarimi: Nr. 8

Pretendimi i operatorit ekonomik ankues N.N.T.SH. "Drini Company" sh.p.k. Prizren, ku thuhet se autoriteti kontraktues ka bërë shkelje të nenit 59 të LPP-së dhe nenit 39 të Rregullave dhe UOPP-së, respektivisht ku ceket: "*OE i rekomanduar për kontrate ka dështuar ti plotësojë këto kritere pasi qe ne dosje te tenderit nuk ka ofruar autorizim origjinal te prodhuesit apo dilerit për trupa ndriçues*", *si dhe ku thuhet: OE PEVLAKU ka ofruar një dokument në të cilin shkruhet se GE lighting e autorizon kompaninë ITE Group sh.p.k, nga Shqipëria e nënshkruar nga kompania VSD MERKUR Skopje, pastaj ITE group sh.p.k. e autorizon kompaninë PEVLAKU (Dëshmia 5. Në këtë rast nuk ka asnjë dëshmi se ITE Group sh.p.k. është distributor i autorizuar i kompanisë GE Lighting,* ekspertja shqyrtues sqaron,operatori ekonomik i rekmaonduar për dhënie të kontratës në ofertë ka ofruar si dëshmi Autorzim nga prodhuesi/dileri, nga kompania " ITE GRUP" Tiranë.

Mirëpo, autoriteti kontraktues me dt. 07.03.2017, konform nenit 72 të LPP-së, ka adresuar te operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë-Kërkesë për dokumentacion dhe informata shtesë, ku thuhet: Keni ofruar trupa ndriçues te GE elektik, nga i njëjti nuk ka asnjë autorizim apo nga përfaqsuesi i autorizuar.

Ekspertja shqyrtues sqaron se operatorit ekonomik i rekomanduar për kontratë, me dt. 08 mars 2017, ka ofruar autorizimin e prodhuesit, ku thuhet ndër të tjera se "GE Lihgting" e autorizon "ITE Grup", për shpërndarjen e produkteve, nënshkruar nga VSD Merkur Skopje, si dhe autorizim nga dileri i autorizuar "ITE Grup" sh.p.k. Tiran, për OE "PE-VLA-KU" sh.p.k. Kosovë.

Sqarimi: Nr. 9

Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankues N.N.T.SH. "Drini Company" sh.p.k. Prizren, ku thuhet: "*OE i rekomanduar për shpërblim me kontrate ne dosje te tenderit ka ofruar autorizim nga kompania IDK Konstruksion nga Shqipëria, kompani e cila merret me ndërtim dhe implementim te projekteve, nuk është as prodhuesi i komponentëve te sinjalizimit horizontale as materialeve të sinjalizimit vertical*" , ekspertja shqyrtues ka dhënë sqarim në konstatimin nr. 4. të raportit.

Sqarimi: Nr. 10

Pretendim i operatorit ekonomik ankues N.N.T.SH. "Drini Company" sh.p.k. Prizren, "Katalogët e dërguara me 13.03.2017 te prodhueseve ITALIAN, janë ne gjuhen Italiane, qe është ne kundërshtim me dispozitat e LPP-se dhe UOPP, pasi qe gjuha italiane nuk është gjuhe zyrtare, dhe nuk e di se si komisioni i vlerësimit i ka pranuar këto dokumente kur janë ne kundërshtim me dispozitat e LPP-se dhe se si ka arritur ta bëjë një vlerësim te produktit te ofruar", ekspertja shqyrtues sqaron se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë ka ofruar katalogun për sinjalistik vertikale nga kompania "VERNISOL" Itali, në gjuhën italiane me shenja të komunikacionit, dhe katalogun nga kompania

"IDK Konstruksion" sinjalistik vertikale në gjuhën shqipe, mirëpo nuk është dhënë përshkrimi teknik, ashtu siç është dhënë në specifikimin teknik te Përshkrimi-sinjalizimi horizontal dhe Përshkrimi-sinjalizimi vertikal.

Ekspertja shqyrtues bazuar ne nenin 13 paragrafi 4 të LPP-së sqaron: *"Një operator ekonomik mund të paraqesë një tender, një kërkesë për pjesëmarrje apo ndonjë dokument tjetër të kërkuar apo që lejohet të plotësohet gjatë aktivitetit të prokurimit, në gjuhën Shqipe, Serbe ose në gjuhën Angleze"*.

Sqarimi: Nr. 11

Sa i pëket pretendimit të operatorit ekonomik ankues N.N.T.SH. "Drini Company" sh.p.k. Prizren, ku ndër të tjera thuhet: *"OE i rekomanduar për kontratë si ne dosje te tenderit edhe ne sqarime shtese te datës 08.03.2017 dhe 13.03.2017 ka dështuar te ofroje produkt i cili i përmbush kërkesat minimale te dosjes se tenderit. Ka ofruar trup ndriçues nga prodhuesi GE lighting tipi SLBT, i cili jetëgjatësinë e llampes ndriçuese e ka > 64 000 ore, (dëshmia 9) kurse ne dosje te tenderit eshte kërkuar te jete > 100 000 ore"*, ekspertja shqyrtues bazuar ne oferten e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë, sqaron se qëndron pretendimi i operatorit ekonomik ankues, për arsy se autoriteti kontraktues në Aneksin 1- Specifikimet teknike të detyrushme te Karakteristikat teknike të ndriçmit, në nr.rendor 6. ka specifikuar: Jetëgjatësia e lampë ndriçuse LED >100.000, ndërsa në operatroi ekonomik I rekomanduar për kontratë ka ofruar GE lighting tipi SLBT, 64000h.

Sqarimi: Nr. 12

Pretendim i operatorit ekonomik ankues N.N.T.SH. "Drini Company" sh.p.k. Prizren, ku thuhet: *"Ne po të njëjten pikë të Ankesit për specifikimet teknike të detyrueshme janë kërkuar Raporetet e testimit për kompatibilitet me standardet EN (te dorëzohen me ofertën) Operatroi ekonomik i rekomanduar për kontratë nuk ka ofruar asnjë certifkatë të atestimeve të cilat janë kërkuar të dorëzohen me ofertë"*, ekspertja shqyrtues sqaron se autoriteti kontraktues përmes përgjigjeve ne pytjet e parashtuar, ka specifikuar se lidhur me kërkesën e specifikuar ne nenin 9.1 dhe 9.2 të FTD-së: Operatori Ekonomik duhet të prezantoj certifikata EN dhe protokolle të testimit për produktet e ofruara – sipas annex 1 - specifikimet teknike të detyrueshme (vlen për OE fitues).

Ekspertja shqyrtues sqaron se në shkresat e lëndës respektivisht ne ofertën e operatorit ekonomik të rekomanduar për kontratë, nuk ka hasur dëshmi se ka ofruara certifikata EN dhe protokolle të testitmti për produktet e ofruara.

Sqarimi: Nr. 13

Lidhur me pretendimin e operatroti ekonomik ankues N.N.T.SH. "Drini Company" sh.p.k. Prizren, ku thuhet: *"Operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë, ka bere shkelje flagrante te nenit 27 te LPP-se DOSJA E TENDERIT – dhe nenit 18, 45 te rregullave dhe UOPP-se, pasi qe OE nuk ka plotësuar formularin Standard te dorëzuar nga AK mirëpo ka e ka përvetësuar listën e çmimeve, gjë që është në kundërshtim me nenet e larte cekura"*, ekspertja shqyrtues sqaron se operatori ekonomik i rekomanduar për kontratë, ka plotësuar Pjesën I. Formularin e tenderit, mirëpo te Pjesa II. Paramasa dhe Parallogari, është plotësuar Paramasa dhe Parallogaria me të gjitha të dhenat e kërkuara, në përjashtim të fjalisë Pjesa II. Paramasa dhe Parallogari.

Me qenë se operatori ekonomik i rekomanduar për kontrarë ka plotësuar formularin e tenderit, paramasen dhe parallogarin per punët që duhet të kryhen , ekspertja shqyrtues sqaron se ne rastin konkret kjo mund të konsiderohet si devijim i vogël konform nenit 59 paragrafi 4 pika (ii) e LPP-së.

Sqarimi: Nr. 14.

Pretendim i operatorit ekonomik ankues N.N.T.SH. "Drini Company" sh.p.k. Prizren, ku thuhet: "*OE i rekomanduar për kontratë ka dështuar të ofroj dëshmi të mjaftueshme për kapacitete profesionale dhe teknike sipas kërkesave të dosjes së tenderit: Ne listën e mjeteve të paraqitur ne dosje te tenderit nuk Kamion te cilët i plotësojnë kushtin administrativ te dosjes se tenderit. Makina Finisher - shtresues i asfaltit, nuk është ne listën e prezantuar të makinerive, qe është në kundërshtim me kërkesat e dosjes se tenderit*", ekspertja shqyrtues sqaron, në Listen e makinerive dhe stabilimenteve të prezentuara nga operatori ekonomik rekomanduar për kontratë, nuk është prezentuar pajisjen Finisher, mirëpo operatori ekonomik në fjalë ka ofruar Kontratë qiraje, me shoqërin "Vëllazëria" sh.p.k. Shqipri, për automjetin Shtresues e asfati, tip SB/131, me nr. Matrikullimi E351, përmes së ciles dekalron se këtë mjete ja jep me qira shoqerisë qiramarrse "PE-VLA-KU" sh.p.k, përfaqësia ne Kosovë, me afatë 1 (një) vjeqar. Bashkngjitur: Vërtetimin e zhdoganimi dhe DUD.

Sqarimi: Nr. 15.

Bazuar ne shkresat e lëndës që ka pasur në shqyrtim, ekspertja shqyrtues sqaron se autoritet kontraktues me rastin e hartimit të dosjes së tenderit për aktivitetin e prokurimit **"Ndërtimi i rrugës Bujar Roka – pjesa jugore e qytetit në Gjakovë"**, me nr. të prokurimit: **632/16/081/511,** nuk ka respektuar nenin 27 dhe nenin 28 të LPP-së, per arsye se te kërkesat mbi mundësit teknike dhe profesionale ka specifikuar kërkesa vlen vetëm për fituesin. Bazuar në nenin 26 paragrafi 5 Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurim Publik-A-01, ekspertja shqyrtues sqaron se kërkesat mbi mundësit teknik dhe profesionale janë kriteret për kualifikim të operatorve ekonomik, ndërsa dëshmitë apo provat lidhur me pranushmërin e OE, të cilat mund të kërkohen të dorëzohen nga tenderuesi të cilit autoriteti kontraktues synon t'ia japë kontratën, janë të paraparë në nenin 6.4 të FTD-së.

Po ashtu në Aneksin 1-Specifikimin teknike të detyrushem, ne pozicionin 98, ka specifikuar si në vjim: *Furnzimi i transporti montimi i ndërprerësve AS-150A-Shneider*, që nënkupton se është cekur emrin e prodhuesit, që është ne kundërshtim me nenin 28 paragrafi 7 të LPP-së dhe nenin 20.8, Rregullat dhe Udhëzuesi Operativ për Prokurimin Publik-A01.

Mendimi i Ekspertit Shqyrtues

Gjatë analizimit të dosjes së tenderit dhe procedurës së zhvilluar për aktivitetin e prokurimit **"Ndërtimi i rrugës Bujar Roka–pjesa jugore e qytetit në Gjakovë"**, me nr. të prokurimit: 632/16/081/511, si dhe duke pasur parasysh konstatimin nr. 15, i propozon panelit shqyrtues që ankesën e operatorit ekonomik ankues "Lika Trade" sh.p.k. – Deçan, ta refuzoj si të pabazuar, ankesën e operatorit ekonomik ankues "Euroasphalt" sh.p.k .- Gjakovë, ta aprovoj si pjesërisht të bazuar, dhe ankesën e operatorit ekonomik ankues N.N.T.SH. "Drini Company" sh.p.k. Prizren, ta aprovoj si të bazuar, ndërsa lënda ta kthehej në Ritenderim. .